

VENDIM
Nr. 242, datë 30.4.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “URBANIZIMI I BLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN ‘SAVËR’”, BASHKIA LUSHNJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Urbanizimi i bllokut të banimit në lagjen ‘Savër’”, Bashkia Lushnjë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “ndërtesë” dhe “njësi”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 069 220.8 (një milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet pikë tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 069 220.8 (një milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e njëzet pikë tetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Bashkia Lushnjë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Lushnjë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyj në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “URBANIZIMI I BLLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN ‘SAVËR’”, BASHKIA LUSHNJË

N. r.	Pronari			Të dhëna kadastrale (sipas kartës së pasurisë)										Vlerësimet për shpronësimin						Shënimet (kuftësimet hipotekare, barrë mbi pasuritë etj.)
														"Tërthor"			"Ndërtesë"			
	Emri	Adresa	Mbënim	Fshati ose qyteti	Z. kod rural	Nr. i pasurisë	Llogji pasurisë	Sipërfaqja totale	"Tërthor" (m ²)	"Ndërtesë" (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Cmimi (ëke/m ²)	Vlera (ëke)	Sipërfaqja (m ²)	Cmimi (ëke/m ²)	Vlera (ëke)		
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18		
1	BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARUARA TË SHQIPËRISË			LUSHNJË	326.8	4/20	Ndërtesë	390		390	6	174			378.0		757,648.0	757,648.0		
2	LIJAJANA	ZOI	CURR A	LUSHNJË	326.8	4/157-NI	Njësi	25		25	11	179			25.0		311,572.8	311,572.8		
VLERAT TOTALE																		1,069,220.8		

Vlerësimi i pasurive të llojit “ndërtesë” dhe “njësi” është me preventiv punimesh, bazuar në pikën 3, të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërbërimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.